

Nuhi Tërshani është Menaxher Senior i Projekteve në organizatën TOKA, me përvojë pesë vjeçare në zhvillimin dhe udhëheqjen e programeve rinore në Kosovë dhe në nivel ndërkombëtar. Ai e ka nisur angazhimin e tij në TOKA si vullnetar dhe brenda pak viteve, është shndërruar në një nga personat kyç të organizatës, duke udhëhequr një nga programet më të rëndësishme për fuqizimin e të rinjve - Ditën e Solidaritetit - në Kosovë dhe në diasporë.

Përmes këtij programi, Nuhiu në bashkëpunim me ekipin çdo vit angazhon me shumë se 500 të rinj nga 12 komuna të Kosovës duke ndërtuar bashkëpunime të qëndrueshme ndërmjet të rinjve, institucioneve publike, shkollave, partnerëve lokalë e ndërkombëtarë, si dhe sektorit privat. Nën udhëheqjen e tij, programi është zgjeruar për herë të parë jashtë vendit, duke u zbatuar me sukses në diasporë, në qytete si Brukseli dhe Londra, dhe duke hapur rrugë për shtrirje të mëtejshme në Evropë.

Nuhiu është gjithashtu përfaqësues i TOKA në Këshillin e rrjetit evropian SAME (Solidarity Action Day Movement in Europe), ku kontribuon në zhvillimin strategjik të rrjetit dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatave që promovojnë solidaritetin dhe qytetarinë aktive të të rinjve në nivel evropian.

Ai po ashtu vazhdon të udhëheqë kampe rezidenciale me të rinj nga Kosova, rajoni dhe bota, si dhe është i përfshirë në shkrimin e granteve dhe mbledhjen e fondeve për TOKA-n.

Në punën e tij, ai fokusohet në krijimin e mundësive konkrete për përfshirjen e të rinjve, në ndërtimin e partneriteteve me ndikim dhe në fuqizimin e tyre si qytetarë aktivë. Krahas angazhimit të tij profesional, Nuhiu është gjithashtu i angazhuar si trajner i volejbollit në një shkollë volejboli në Prishtinë. Njëkohësisht, ai ndjek studimet në Universitetin e Prishtinës, në degën Teknologji Ushqimore me Bioteknologji.

I motivuar nga vlerat e bashkëpunimit, gjithëpërfshirjes dhe ndikimit afatgjatë, ai është i përkushtuar që ta përfaqësojë zërin e të rinjve të Kosovës me integritet, përgjegjësi dhe vizion, duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit, dialogut dhe mirëkuptimit në rajon.